

VENDIM
Nr. 99, datë 24.2.1997

**PËR PËRCAKTIMIN E DISA KRITEREVE LOKALE PËR TRAJTIMIN ME NDIHMË
EKONOMIKE TË FAMILJEVE QË JANË NË VËSHTIRËSI EKONOMIKE**

Me propozimin e Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Këshillat e bashkive dhe të komunave kanë të drejtën të përcaktojnë disa kriterë lokale për trajtimin me ndihmë ekonomike të familjeve, në bazë të gjendjes socialekonomike të tyre.

Në këto kriterë do të merren parasysh niveli i të ardhurave të familjeve, gjendja sociale e shkaktuar nga humbja në firmat rentiere, humbja e shtëpive, si dhe kushtet shëndetësore të personave të familjes.

2. Ky vendim do të zbatohet vetëm për fondin shtesë të akorduar për mënjanimin e pasojave socialekonomike të krijuara.

3. Fondi shtesë i ndihmës ekonomike, i akorduar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.70, datë 17.2.1997, do të çelet për një periudhë njëmuajore, në momentin që njësitë do të paraqesin kërkesat e tyre pranë Administratës së Përgjithshme të Ndihmës dhe Shërbimeve Sociale, e cila bën vlerësimin sipas kriterëve të përfitimit të ndihmës ekonomike, në bazë të dispozitave ligjore në fuqi.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen këshillat e bashkive dhe të komunave.

5. Ngarkohet Administrata e Ndihmës dhe e Shërbimeve Sociale për përgatitjen e udhëzimit përkatës në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi